



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR

# PLANI SOCIAL I BASHKISË SKRAPAR 2020-2022





VKB NR.57, DATË  
26.10.2020(1)(1).pdf

*Plani Social u hartua me mbështetjen e Programit “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale”, financuar nga Fondi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, një program dyvjeçar që nxit ndryshime të mëtejshme në sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror në nivelin lokal (bashkiak), si pjesë e një sistemi efektiv të integruar të mbrojtjes sociale. Zbatimi dhe koordinimi i këtij programi drejtohet nga PNUD.*

*Ky program ngrihet mbi eksperiencën e gjerë të OKB në adresimin e përfshirjes e mbrojtjes sociale dhe nevojave të grupeve më vulnerabël përfshirë romët, refugjatët dhe emigrantët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë vulnerabiliteti, të moshuarit, gratë në zonat rurale dhe gratë e rrezikuara nga dhuna me bazë gjinore. Ai mbështet zbatimin e vizionit të ri të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratën e vendit për tu integruar në Bashkimin European.*

*Përmirësimi i përfshirjes së sociale të grupeve më vulnerabël në Shqipëri po mbështetet nga ndërhyrje në nivelin makro (qeveria qendrore dhe shërbimet kombëtare), dhe nivelit lokal (bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile), si dhe në nivelin mikro duke përfshirë aktivisht grupet e targetuara nga projekti në procesin e zbatimit të tij.*

## PERMBAJTJA

.....	1
<b>HYRJE</b> .....	5
<b>1. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE</b> .....	7
<b>1.1 Vizioni</b> .....	7
<b>1.2 Misioni</b> .....	7
<b>1.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese</b> .....	7
<b>1.3.1.Vlerat</b> .....	7
<b>1.3.2. Parimet udhëheqëse</b> .....	7
<b>1.3.3.Synimet</b> .....	8
<b>2. ANALIZA E SITUATËS</b> .....	9
<b>2. 1 Kuadri Strategjik</b> .....	9
<b>2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime</b> .....	12
<b>2.2.1 Të dhëna demografike</b> .....	12
<b>2.2.2 Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe josatistikore</b> .....	15
<i>Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët</i> .....	18
<b>2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale</b> .....	19
<b>2.3.1 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë</b> .....	19
<b>2.3.1.1. Shërbime mbështetëse apo fuqizuese për familjet përfituese të ndihmës ekonomike</b> .....	19
<b>2.3.1.2. Shërbime për punëkërkuesit e papunë</b> .....	19
<b>2.3.1.3. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara</b> .....	19
<b>2.3.1.4. Sistemi komunitar i mbrojtjes dhe përkujdesit për fëmijë</b> .....	20

2.3.1.5. Shërbime për viktimat e dhunës në familje .....	20
2.3.1.6. Shërbimi i strehimit social .....	21
2.3.1.7. Shërbime për të moshuarit.....	21
2.3.2 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Qarkut Berat.....	22
2.4 Mangësitë në shërbime.....	23
2.5 Analiza SWOT .....	26
<b>3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT .....</b>	<b>27</b>
3.1 Qëllimet.....	29
3.2 Objektivat, rezultatet e pritshme dhe vlerësimi I tyre.....	29
<b>4. PLANI I VEPRIMIT .....</b>	<b>33</b>
<b>5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI .....</b>	<b>56</b>
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>57</b>
<b>SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR.....</b>	<b>59</b>
<b>SHTOJCA 2. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR .....</b>	<b>61</b>

## HYRJE

Bashkia Skrapar përbëhet nga nëntë njësi administrative: Qëndër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Bashkia e re e Skraparit kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 16,992 banorë (Regjistri gjendjes civile, 1 Janar 2020). Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 105 fshatra. Bashkia e re e Skraparit ka një relieft të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km<sup>2</sup>. Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 22.93 banorë/km<sup>2</sup>.

Duke konsideruar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, por edhe situatën e grupeve në nevojë në territorin e saj, Bashkia Skrapar konsideron të rëndësishëm planifikimin strategjik për shërbimet e kujdesit shoqëror. E mbështetur nga programi “Joint SDG” i Kombëve të Bashkuara struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki nisi në Maj 2020 procesin e hartimit të Planit Social Vendor. Hartimit të këtij Plani i parapriu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror për Bashkinë Skrapar, i cili identifikoi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet ekzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimit njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Grupi lokal i Bashkisë Skrapar i përbërë nga stafi i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK, administratorët shoqëror në njësitë administrative, të mbështetur nga konsulenti kombëtar përdorën përgjatë procesit të identifikimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror kombinim të teknikave të ndryshme: (1) U analizua legjislacioni kombëtar për të identifikuar standartin udhërrëfyes në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror<sup>1</sup>. U kërkuan Plane strategjike të mundshme lokale dhe procedura pune që ndiqen në këtë Bashki. U konsultua Rregullorja e Brendshme e Bashkisë për të identifikuar rolet dhe funksionet jo vetëm të strukturave ekzistuese në Bashki në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe të njësive të tjera brenda Bashkisë me të cilat duhet ndërvepruar gjatë fazës së përgatitjes së Planit Social, si dhe duhen përfshirë më pas në fazën e zbatimit dhe monitorimit të Planit; (2) U analizuan raporte studimore të mëparshme,

---

<sup>1</sup> Tek Referencat gjeni listën e plotë të paketës legjislative të konsultuar

kombëtare dhe lokale, të cilat shërbyen për të analizuar dhe krahasuar të dhënat e Bashkisë Skrapar me treguesit mesatarë kombëtarë; (3) U identifikuan dhe u mbledhën një numër të dhënash statistikore dhe jo statistikore nga institucione kombëtare dhe lokale, si: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Administratorët shoqëror dhe të dhëna të Sektorit të Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror, Rregjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike, Zyra Vendore e Agjencisë Kombëtare për Punësim Aftësim - Skrapar, Strukturat Arsimore dhe Shëndetësore në Skrapar; Policia, etj. Të dhënat u mbledhën në periudhën 15 Maj - 30 Maj 2020. Të dhënat shërbyen për të identifikuar grupet më të përjashtuara në territorin e bashkisë. (3) Konsulenti Kombëtarë analizoi të dhënat e mbledhura dhe përmes krahasimit me standartin kombëtar hartoi draftin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror. Raporti dhe gjetjet e tij fillestare u konsultuan në një tryezë me pjesëmarrjen e specialistëve dhe drejtuesve ekzekutivë dhe politikë të bashkisë, përfshirë anëtarët e Këshillit Bashkiak, më 11 qershor 2020. Tryeza synoi saktësimin e të dhënave e gjetjeve të Raportit, si dhe identifikimin e prioriteteve për ngritjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Skrapar. Në përputhje me vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj të identifikuar përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimet me stafin dhe aktorët e tjerë, si dhe shportën bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror<sup>2</sup>, Bashkia Skrapar identifikoi dhe planifikoi përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e saj, pjesë e Planit Social Social 2020-2022.

Pavarësisht përpjekjes për të mbledhur të dhëna sa më të sakta e të plota për të identifikuar grupet në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë Skrapar, ka një pranim të përgjithshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces se mund të egzistojnë në territor grupe të tjera në nevojë për shërbime që nuk u arritën të identifikohen për dy arsye kryesore: (1) Mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë që edhe pse ekzistojnë, nuk rregjistrohen të dhëna për ta; (2) Pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore në Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësitë administrative të cilat ushtrojnë funksionin e identifikimit, menaxhimit dhe referimit të rasteve në nevojë për shërbime, që kufizon mundësinë për të punuar në mënyrë proaktive në territor e për rrjedhojë kufizon edhe saktësinë e të dhënave të mbledhura mbi të cilat është punuar e përgatitur ky Raport.

---

<sup>2</sup> Sipas VKM 518, datë date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

# 1. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

## 1.1 Vizioni

Sigurimi i mundësisë së përdorimit të shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Skrapar.

## 1.2 Misioni

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Skrapar do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJQ-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

## 1.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese

### 1.3.1.Vlerat

- ✓ Plani Social i Bashkisë Skrapar përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:
- ✓ Ngritjen e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Krijimin e Fondit Social dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij me efektivitet;
- ✓ Përmirësimin e legjislacionit të shërbimeve sociale duke synuar sigurimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të individëve dhe grupeve në nevojë.
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

### 1.3.2. Parimet udhëheqëse

Hartimi i Planit Social të Bashkisë Skrapar udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;

- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të inetresit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të inetresit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.
- ✓ Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

### 1.3.3.Synimet

Me qëllim që të hartohet një sistem shërbimi efektiv dhe në përputhje me nevojat e qytetarit, është e nevojshme që ndërhyrja publike të përfshirjë kërkesën (qytetarin), ofertën (tregun) si edhe mekanizmat ndërmjetës/lidhës (institucionet). Për rrjedhojë, synimet e përgjithshme të Planit Social janë:

- ✓ Deri në vitin 2022, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë. (institucionet)
- ✓ Të sigurojë ndërtimin dhe forcimin e sistemit të kujdesit social në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme për të gjithë ata që kanë nevojë për kujdes. (oferta e tregut)
- ✓ Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.(kërkesa e tregut)



## 2. ANALIZA E SITUATËS

### 2.1 Kuadri Strategjik

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e kanë rrënjën e tyre tek politikat dhe standartet kombëtare. **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020** ka reflektuar angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore. Tre janë politikat<sup>3</sup> e formuluar në këtë strategji mbi të cilat synohet të mundësohet mbrojtje, përfshirje dhe rintegrim social për personat dhe familjet e prekura nga varfëria, si dhe individë në situatë vulnerabiliteti: **(1) Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë; (2) Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara; (3) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social.**

E përbashkëta e tre politikave qëndron në lidhjen që krijohet tashmë midis programit të pagesave monetare (ndihma ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara) me shërbimet e kujdesit shoqëror të cilat në thelb duhet të luajnë një rol kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, për fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale. Specifikisht, në këndvështrimin e programit të ndihmës ekonomike, Strategjia thekson se “Duhet rritur ndërlidhjet e shërbimeve ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike, në shëndetësi, arsim, strehim, apo tjetër dhe duhet synuar konsolidimi i një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike”<sup>4</sup>, duke përcaktuar kështu si një nga ndërhyrjet prioritare masa/shërbime për riintegrimin social të përfituesve të Ndihmës Ekonomike. Një nga objektivat e Strategjisë në këndvështrimin e përmirësimit të cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara është “krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020”<sup>5</sup>. **Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social**, Strategjia e sheh të lidhur me zbatimin e parimit të decentralizimit dhe të deinstitucionalizimit. **Synohet ngritja dhe funksionimi i një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore.** Në vend të shërbimeve rezidenciale synohet ngritja dhe funksionimi i shërbimeve komunitare që i përgjigjen nevojave të identifikuar të individëve e familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Çdo fëmijë, apo/dhe i rritur, si dhe familje shqiptare

---

<sup>3</sup> *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015- 2020, fq.24, aksesuar në [https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Mbrojtjen\\_Sociale\\_2015-2020.pdf](https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf)*

<sup>4</sup> *Idem, Fq.16*

<sup>5</sup> *Idem, Fq.25*

duhet të kenë akses të barabartë dhe të përfitojnë nga një sistem funksional dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Bazuar në këtë Strategji, por edhe në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, sikurse Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, **Bashkitë janë aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar dhe si të tilla ato duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të këtyre shërbimeve.**

**Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht: (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. (4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

**Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”** dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. Neni 36 i këtij Ligji ngarkon Bashkinë për të ofruar dhe administruar shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke: identifikuar nevojat; vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; hartuar planin social vendor; programuar buxhetet vendore; planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore; kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

**Hartimi i Planit Social** nga njësitë e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar i vjen në ndihmë Bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël. Kjo paketë shërbimesh është konsoliduar përmes **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për**

**përfituesit e shërbimit të organizuar**". Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror identifikohen nga Bashkia përmes proceseve konsultuese dhe ato harmonizohen në Planin Social lokal, por shërbimet mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublik. Bashkia duhet të drejtojë jo vetëm procesin e identifikimit të nevojave, por edhe koordinimin e kontributeve që mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm publik e jopublik dhe reflektimin e tyre në këtë Plan.

**Financimi i shërbimeve** është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe në pikën 2 të **VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social"**, sipas të cilit çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) *fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;* (b) *fondet nga buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore;*(c) *të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë;* (ç) *tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.* Jo vetëm ligji, por edhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave i sipërcituar kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë me ekzistencën e Planit Social të saj. Ndërkohë **VKM 150, datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"**, ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përlllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia.

Për të ngritur sisteme komunitare të qëndrueshme të kujdesit shoqëror është e domosdoshme që Bashkia të strukturat e duhura dhe stafe të dedikuara në të dy nivelet e organizimit të saj. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë **bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.** Analiza e kuadrit ligjor<sup>6</sup> ekzistues të çon në këto role dhe funksione të dy strukturave që duhet të ngrihen e funksionojnë për ta bërë legjislacionin të zbatueshëm:

**(1) Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, e krijuar pranë Bashkisë, duhet të sigurojë: drejtimin strategjik, planifikimin, ngritjen, funksionimin, financimin, monitorimin dhe mbështetjen me kapacitete të sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit**

<sup>6</sup> Ligji "Për vetqeverisjen vendore", Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, ndryshuar, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"; Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 (ndryshuar) "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"; Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

**shoqëror.** Ndërkohë kjo strukturë kryen dhe funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sikurse në përputhje me VKM Nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” ka në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje. Në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, pjesë e kësaj strukture është edhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, e cila ushtron rolet dhe funksione që rrjedhin nga ky ligj.

**(2) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ngrihet<sup>7</sup> në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë,** me përjashtim të Bashkive me më pak se 6 mijë banorë, dhe në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ajo duhet të përmbushë detyra që lidhen me identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë, menaxhimin e rasteve, referimin tek shërbimet, informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim për punësim, për pagesat sociale në të holla; Në përbërje të kësaj Njësie duhet të ketë të paktën: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6.000 deri në 10.000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë<sup>8</sup>; një administrator shoqëror<sup>9</sup>;

## 2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime

### 2.2.1 Të dhëna demografike


Të dhënat demografike janë të rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar madhësinë e grupeve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë e Bashkisë Skrapar, por edhe për të vlerësuar burimet njerëzore që duhet të ketë Bashkia në dy nivelet e organizimit (Bashki dhe njësi administrative) si detyrim që rrjedh nga legjislacioni kombëtar.

---

<sup>7</sup> Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

<sup>8</sup> Kjo në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

<sup>9</sup> Detyra sipas Ligjit "Për ndihmën ekonomike"




Burimi: Zyra e Gjendjes Civile - Bashkia Skrapar, 2020

Bashkia Skrapar përbëhet nga nëntë njësi administrative: Qëndër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Bashkia e re e Skraparit kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 16,992 banorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 105 fshatra. Duke ju referuar grup moshave të dhënat flasin për :

- 2,194 janë fëmijë të grup moshës 0-15 vjeç (13%),
- 12,286 janë fëmijë të rritur të moshës 16 deri 64 vjeç (72%)
- 2,512 janë të moshuar mbi 65 vjeç (15%)

**Figura 2: Popullsia sipas grup moshave**



Burimi: INSTAT, 2020

Në Figurën 2 paraqiten në mënyrë të detajuar shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave në territorin e Bashkisë.

Në tabelën 1 paraqiten në mënyrë të detajuar shpërndarja e popullsisë sipas grup moshave në territorin e Bashkisë, mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile.

**Tabela 1: Popullsia sipas grupmoshave**

Njësia Administrative	Numri Popullsisë	Popullsia sipas grupmoshave				
		0-6 vjeç	7-15 vjeç	16-18 vjeç	19-64 vjeç	65+ vjeç
BOGOVË	1693	33	190	169	1078	223
ÇEPAN	913	20	145	152	471	125
ÇOROVODË	5666	165	401	228	3991	881
GJERBËS	1210	36	148	178	691	157
LESHNJE	735	29	88	64	454	100
POTOM	1055	34	102	90	692	137
QENDER	3834	95	409	220	2517	593
VËNDRESHE	1098	72	185	61	624	156
ZHEPË	788	16	26	13	593	140
<b>GJITHSEJ</b>	<b>16,992</b>	<b>500</b>	<b>1,694</b>	<b>1,175</b>	<b>11,111</b>	<b>2,512</b>

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, 2020

### 2.2.2 Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe josatistikore<sup>10</sup>

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, që prezantohet gjerësisht në vijim identifikoi faktin që në territorin e Bashkisë Skrapar janë të paktën 2301 individë, ose 13.5% e popullsisë, që kanë të nevojshëm të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në fakt numrin më të lartë të individëve në nevojë për shërbime e gjejmë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

**Tabela 2. Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë**


<b>NJËSIA ADMINISTRATIVE</b>	<b>NR.POPULLSIE</b>	<b>NR. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME KUJDESI SHOQEROR</b>	<b>%</b>
BOGOVË	1,693	156	9%
ÇEPAN	913	99	11%
ÇOROVODË	5,666	757	13%
GJERBËS	1,210	168	14%
LESHNJE	735	118	16%
POTOM	1,055	227	21%
QENDER	3,834	451	12%
VËNDRESHE	1,098	145	13%
ZHEPË	788	180	23%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>16,992</b>	<b>2,301</b>	<b>13.5%</b>

Burimi: Sektori i Ndihmës Ekonomike, Bashkia Skrapar, 2019

Konstatohet që njësitë administrative mbi mesataren në nivel Bashkie janë njësitë Potom dhe Zhepë por në përgjithësi të gjitha Njësitë Administrative kanë përqindje të përafërta të individëve

<sup>10</sup> Në Shtojcën 1 gjeni Treguesit e detajuar të analizuar

në nevojë për shërbime duke përfshirë këtu dhe zonën urbane të Çorovodës.



Burimi: Sektori i Ndhmës Ekonomike, Bashkia Skrapar, 2019

#### *Individë në nevojë sipas skemës së ndihmës ekonomike*

Të dhënat e muajit shtator 2019 dëshmojnë se 443 familje përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Skrapar. Numri më i lartë i aplikuesve për ndihmë ekonomike në të dy vitet e analizuar është në njësinë administrative Qendër. Nga analiza e të dhënave rezulton :

- 44% të familjeve përfituese e përbëjnë familjet me 4 anëtarë;
- Edhe përqindjet e familjeve me 3 dhe 5 anëtarë janë të konsiderueshme, përkatësisht 24% dhe 22%;
- 9% e familjeve përfituese kanë në përbërje anëtarë me AK;
- Në 4% të familjeve përfituese, mbajtësi është grua;
- 1% e familjeve përfituese kanë në përbërje fëmijë me AK.
- 56% e përfituesve të NE janë fëmijë.

Njësitë Zhepë, Potom, Leshnje dhe Vëndreshe karakterizohen për pjesën më të lartë të familjeve përfituese në raport me popullsinë, mëse dy herë më të lartë se sa pesha në përqindje e përfituesve të ndihmës ekonomike në njësitë e tjera. Ky përfundim vlen edhe për vitin 2018, edhe për vitin 2019.



Analiza tregoi se familjet përfituese të NE janë thuajse tërësisht rurale, ndonëse i gjithë territori i Bashkisë është i konsideruar vendbanim rural. Fëmijët zënë një peshë të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjeve përfituese të NE, gjë e cila duhet të konsiderohet në hartimin e politikave lokale të mbështetjes nëpërmjet NE ose formave të tjera të shërbimeve sociale.

Familjet përfituese të NE kanë në përbërje të tyre individë me AK, gjë e cila e vështirëson situatën sociale dhe ekonomike të familjes, sidomos në raport me tregun e punës, duke zvogëluar mundësitë e punësimit, përfshirjes dhe integritit të familjes. Familjet përfituese të NE, në të cilat mbajtësi është grua, zënë gjithashtu një peshë të konsiderueshme.

Megjithatë, fakti që numri i individëve të varfër, i përkufizuar në përputhje me standartin kombëtar të varfërisë, është më i vogël se sa numri i përfituesve të ndihmës ekonomike, duhet të shërbejë si një drejtim për analiza më të thelluara, të cilat jo vetëm do të ndikonin në rritjen e efektivitetit të ndihmës ekonomike, por edhe do të ri-dimensiononin fondet përkatëse, në përputhje me drejtimet më prioritare.

### ***Punëkërkuetit***

Janë gjithsej 430 punëkërkuetit të papunë në Bashkinë Skrapar. Papunësia ka profil më së shumti urban edhe për arsye se banorët që posedojnë tokë nuk mund të konsiderohen të papunë. Vihet re se gratë kryefamiljare përbëjnë grupin kryesor të punëkërkuetitve. Gjithashtu konstatohet se papunësia është edhe faktori kryesor që i shtyn familjet drejt Ndihmës Ekonomike sepse siç konfirmohet nga të dhënat 21% e punëkërkuetitve të papunë janë përfitues të ndihmës ekonomike.

### ***Individë me aftësi të kufizuara***

2% e popullsisë në Bashkinë Skrapar (referuar të dhënave të Zyrës për Gjendjen Civile) përfiton nga programi i pagesave monetare të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar. Nga 382 persona me aftësi të kufizuar 125 persona (33%) kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për pasojë kanë një ndihmës (kujdestar) që kujdeset për ta. Ndër tre grupet e aftësisë së kufizuar grupi më i madh është i personave me probleme të shëndetit fizik/mendor. Ata përbëjnë 65% të personave me aftësi të kufizuar në këtë Bashki.

33 % e individëve me AK kanë nevojë për një kujdestar.

33% e personave me aftësi të kufizuara banojnë në Çorovodë, 21% e tyre banojnë në njësinë administrative Qendër, ndërsa 47% banojnë në njësitë e tjera administrative të shpërndarë pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme.

Aftësia e kufizuar është një faktorët më kritikë të përjashtimit shoqëror. Në Bashkinë Skrapar, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë përjashtim të shumfishtë sepse përveç aftësisë së kufizuar, janë të përjashtuar nga tregu i punës si edhe nga mundësia për të siguruar një nivel të pranueshëm jetese.

### ***Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët***

Grupet e fëmijëve të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi janë:

- Fëmijë me aftësi të kufizuar (32 fëmijë me aftësi të kufizuara, pra 8% e PAK në Bashkinë Skrapar janë të grup moshës 0-18 vjeç);
- Fëmijë me aftësi të kufizuar, sidomos fëmijë të familjeve përfituese të NE (1% e familjeve përfituese të NE kanë në përbërje fëmijë me AK);
- Fëmijë të familjeve në NE (622) e përfituesve të NE janë fëmijë);
- Fëmijë të familjeve me një mbajtës, sidomos në rastet kur mbajtësi i vetëm është grua (në 4% të familjeve përfituese të NE, mbajtësi është grua).

Ndonëse nuk raportohen raste të fëmijëve në nevojë, kjo nuk dëshmon për mungesën e rasteve të fëmijëve në nevojë, por për mungesën e kapaciteteve të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë, e cila nuk kushtëzohet vetëm nga krijimi i NjMF, por çka është më thelbësore, duhet të krijohen dhe funksionojnë shërbimet me bazë komunitare, si edhe duhet të investohet në rritjen e kapaciteteve profesionale të qeverisjes vendore.

### ***Viktima të dhunës në familje***

2 raste të dhunës në familje janë rregjistruar gjatë vitit 2019 në Bashkinë Skrapar. Dhuna në familje prek më së shumti gratë dhe fëmijët si dëshmitar të dhunës që ushtrohet ndaj nënës së tyre.

Në Bashkinë Skrapar, çështjet e dhunës në familje trajtohen nga NjMF. Ndonëse ekipi multidisiplinar i trajtimit të rasteve është krijuar, drejtuesit e institucioneve nuk mblidhen periodikisht për të diskutuar mbi situatën e dhunës apo masat që ndërmerren. Grupet teknike mblidhen me kërkesën e Sektorit të Mirëqënies Sociale dhe Përkujdesjes Shoqërore në Bashkinë Skrapar, por ka ndryshime të shpeshta të punonjësve të institucioneve të tjera, të cilët shpesh nuk janë të trajnuar për çështjet e dhunës në familje.

### ***Të pastrehë***

Sipas informacioneve të Bashkisë Skrapar, në territorin e kësaj bashkie ka 210 të pastrehë , por çështjet e strehimit nuk adresohen nga asnjë prej drejtorive apo sektorëve aktualë të Bashkisë. Nuk zbatohen në Bashkinë Skrapar asnjë prej formave të strehimit social, të tilla si bonusi i qerasë, banesat sociale etj. Çështja e strehimit social është krejtësisht e patrajtuar. Edhe informacioni mbi

kërkesën për strehim është gjithashtu i patrajtuar. Në programin e politikave sociale të Bashkisë Skrapar, çështja e strehimit duhet të trajtohet, së pari për të njohur nevojën reale, së dyti për të vlerësuar mundësitë e trajtimit dhe së fundi, për ta përfshirë në programin e politikave sociale lokale.

### ***Të moshuar në nevojë për shërbime***

0.2% e popullsisë mbi 65 vjeç përfshihet në grupin e familjeve përfituese të NE. 31% e të moshuarve (mbi 65 vjeç) jetojnë në vetmi, ndërsa rreth 5% e tyre janë në nevojë për shërbime.

## **2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale**

### **2.3.1 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë**

#### **2.3.1.1. Shërbime mbështetëse apo fuqizuese për familjet përfituese të ndihmës ekonomike**

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Individët me aftësi të kufizuar, përfshirë fëmijët;
- Familjet e varfëra;
- Fëmijë në nevojë për mbrojtje;
- Gra të vetme, mbajtëse të familjes;
- Gra të dhunuara;
- Të moshuar të vetmuar.

Bashkia nuk ka aktualisht programe specifike për fuqizimin ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo individ madhor i këtyre familjeve drejtohet tek Zyra e Punës në Berat, në varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

**2.3.1.2. Shërbime për punëkërkuesit e papunë:** Me përjashtim të pagesës së papunësisë e cila mbulohet nga Zyra e Punës e Beratit, në Bashkinë Skrapar nuk ofrohet asnjë shërbim.

#### **2.3.1.3. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara**

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- ✓ Personat me probleme të shëndetit mendor
- ✓ Paraplegjikët
- ✓ Të verbërit
- ✓ Invalidët e punës

Asnjë shërbim i kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara nuk ekziston në territorin e Bashkisë.

#### 2.3.1.4. Sistemi komunitar i mbrojtjes dhe përkujdesit për fëmijë

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- ✓ Fëmijë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike
- ✓ Fëmijë me aftësi të kufizuara
- ✓ Fëmijë në nevojë për mbrojtje

Çdo rast i fëmijëve në nevojë për mbrojtje menaxhohet nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (që kryen edhe detyrën e koordinatorit për masa kundër dhunës në familje, si dhe të specialistit të strehimit), në ndërveprim me grupet teknike ndërsektoriale.

Sfidë mbetet mungesa e çdo lloj shërbimi kujdesi shoqëror për fëmijët në territorin e Bashkisë Skrapar.

Ndonëse nuk raportohen raste të fëmijëve në nevojë, kjo nuk dëshmon për mungesën e rasteve të fëmijëve në nevojë, por për mungesën e kapaciteteve të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë, e cila nuk kushtëzohet vetëm nga krijimi i NjMF, por çka është më thelbësore, duhet të krijohen dhe funksionojnë shërbimet me bazë komunitare, si edhe duhet të investohet në rritjen e kapaciteteve profesionale të qeverisjes vendore.

Nuk ka asnjë çerdhe në territorin e njësisë administrative

Shërbimet e kujdesit parashkollor sigurohen nëpërmjet trajtimit ditor të fëmijëve në kopshte. Janë gjithsej 17 kopshte me një total prej 227 fëmijësh në territorin e Bashkisë. Numri më i madh i kopshteve është në Qendër përkatësisht 29% e kopshteve. Numri më i vogël i kopshteve është në Potom, 1 kopsht dmth 6% e kopshteve. Në Çepan dhe në Zhepë nuk ka asnjë kopsht.

Arsimi i detyrueshëm mbulohet nga 59 shkolla, 11 nga të cilat janë në Qendër. 916 nxënës ndjekin arsimin e detyrueshëm, ndërsa braktisja e shkollës raportohet 0 nxënës. Shërbimi psikologjik në shkolla thujse nuk funksionon, sepse vetëm në Çorovodë ka 1 psikolog të punësuar në shkollë.

Janë 2 shkolla të mesme në Bashkinë Skrapar, në të cilat studjojnë 319 nxënës. Në shtatë njësi administrative nuk ka asnjë shkollë të mesme. Si edhe tek arsimi i detyrueshëm, shërbimi psikologjik në shkolla është i dobët, thujse i pandjeshëm. Vetëm një psikolog është i punësuar në Çorovodë

#### 2.3.1.5. Shërbime për viktimat e dhunës në familje

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- ✓ Viktima të dhunës në familje

- ✓ Gratë dhe fëmijët

Në Bashkinë Skrapar, çështjet e dhunës në familje trajtohen nga NjMF. Ndonëse ekipi multidisiplinar i trajtimit të rasteve është krijuar, drejtuesit e institucioneve nuk mblidhen periodikisht për të diskutuar mbi situatën e dhunës apo masat që ndërmerren. Grupet teknike mblidhen me kërkesën e Sektorit të Mirëqënies Sociale dhe Përkujdesjes Shoqërore në Bashkinë Skrapar, por ka ndryshime të shpeshta të punonjësve të institucioneve të tjera, të cilët shpesh nuk janë të trajnuar për çështjet e dhunës në familje.

#### 2.3.1.6. Shërbimi i strehimit social

Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:

- ✓ Familje/individ që janë të pastrehë dhe që i përkasin kryesisht
- ✓ Familje përfituese të ndihmës ekonomike
- ✓ Persona me aftësi të kufizuara/invalid pune
- ✓ Viktima dhune në familje
- ✓ Të kthyer nga emigracioni në vështirësi ekonomike

Nuk zbatohen në Bashkinë Skrapar asnjë prej formave të strehimit social, të tilla si bonusi i qerasë, banesat sociale etj. Çështja e strehimit social është krejtësisht e patrajtuar. Edhe informacioni mbi kërkesën për strehim është gjithashtu i patrajtuar.

#### 2.3.1.7. Shërbime për të moshuarit

Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:

- ✓ Të moshuar pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike
- ✓ Të moshuar që jetojnë vetëm/të braktisur

Në kushtet e ndërmarrjes së iniciativave në nivel qendror për miratimin e Strategjisë së Moshimit, Bashkia Skrapar duhet të analizojë nën një këndvështrim të ri situatën e të moshuarve, sidomos të atyre që jetojnë të vetëm pasi të dhënat e disponueshme janë të pamjaftueshme për të gjykuar mbi këtë grup, gjë që vështirëson planifikimin e shërbimeve për të moshuarit, sidomos për ata në situatë më kritike.

Sikurse edhe në rastin e dhunës në familje apo mbrojtjes së fëmijëve mungesa e punonjësve social që punojnë për identifikimin, menaxhimin dhe referimin tek shërbimet sjell për pasojë edhe mungesën e informimit të komunitetit se ku dhe si të kërkoj mbështetje, edhe identifikimin e rasteve nga vetë strukturat e Bashkisë.

### 2.3.2 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Qarkut Berat

Qarku Berat përbëhet nga 5 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 141 944 banorë. Bashkia Berat ofron 4 lloje shërbimesh ose 60% të shërbimeve të qarkut, ndërsa Bashkia Kuçovë, popullsia e të cilës është sa  $\frac{1}{2}$  e Beratit, ofron shërbime sa  $\frac{1}{5}$  e shërbimeve të ofruara në Bashkinë Berat. Bashkitë Skrapar dhe Ura Vajgurore, ndonëse me popullsi të konsiderueshme, sidomos Bashkia Ura Vajgurore, ofrojnë shërbime përkatësisht vetëm për “Individë me AK” dhe “Në nevojë”.

27, 43% e shërbimeve të ofruara janë shërbime për “Individë me AK”, ndërsa shërbimet për “Fëmijë” përbëjnë 7% të totalit.

## 2.4 Mangësitë në shërbime

Duke ju referuar shportës së shërbimeve të kujdesit shoqëror<sup>11</sup> në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”<sup>12</sup>, nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror prezantohen në tabelën 3.

**Tabela 3. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve**

INDIVIDE NE NEVOJE PER SHERBIME	BASHKIA Skrapar	TIPET E SHERBIMEVE SIPAS SHPORTES
Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	489	<p>1. <i>Program për fuqizimin ekonomik.</i> Me prioritet 489 individë të familjeve përfituese të NE.</p> <p>2. <i>Informimi dhe këshillimi</i> për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.</p>
Punëkërkues	445	

<sup>11</sup> Në Shtojcën 3 jepet në mënyrë të plotë Shporta e Shërbimeve

<sup>12</sup> Akseuar nga <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf>

Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç	350	<p><b>1. Shërbime rehabilituese</b> për personat në nevojë për aftësim fizik; <b>2. Shërbimet në familje</b> për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; <b>3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur</b> për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.</p>
Invalidë Pune	0	
Fëmijë në nevojë për mbrojtje	0	<p><b>1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line</b>, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës <b>2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, për</b> zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.</p> <p><b>3. Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike; 4. Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;</b></p> <p><b>5. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese</b> për fëmijë me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; <b>6. Shërbimi i emergjencës 72 orë</b> për fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;</p>
Fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike	622	
Fëmijë me aftësi të kufizuara	32	



Individë viktimë dhunë në familje	2	<b>1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line</b> , shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; <b>2. Shërbimi i emergjencës 72 orë, për</b> viktimë të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. <b>3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për</b> viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë. Organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.
Individë në familje të pastreha	210	<b>1. Bonusi i qerasë, 2. banesa sociale me pagesë të reduktuar, 3. kreditë e buta.</b>
Të moshuar në nevojë për shërbime	118	<b>1. Shërbimet në familje</b> për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. <b>2. Qendra ditore</b> për të moshuarit;
Individë në familje që kanë përjetuar divorc	0	<b>1. Shërbim psikosocial</b>

## 2.5 Analiza SWOT

### Fuqi:

- ✓ Kërkesa për shërbime sociale është çështje emergjente sepse shërbimet mungojnë tërësisht.
- ✓ Domosdoshmëria e sigurimit të shërbimeve sociale për grupet më në nevojë kritike është objektiv i Programit Politik të Kryesisë së Bashkisë.
- ✓ Bashkia Skrapar, ndonëse bashki e re, është e motivuar dhe e paisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.

### Dobësi:

- ✓ Mungesa e mbështetjes financiare.
- ✓ Mungesa e Fondit Social.
- ✓ Mungesa e partneriteteve me organizata ndërkombëtare.
- ✓ Prezenca e ulët e organizatave jo fitimrurëse në territorin e Bashkisë.
- ✓ Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- ✓ Pavarësisht decentralizimit, lidhja dhe bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, realizohet nëpërmjet qarkut Berat, jo drejtëpërsëdrejti.

### Mundësi:

- ✓ Reforma e Qeverisjes Vendore.
- ✓ Decentralizimi i shërbimi i sociale.
- ✓ Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.

### Kufizime

- ✓ Interesi i ulët i organizatave jo fitimprurëse për të punuar në Skrapar.
- ✓ Pësia e lartë specifike e shërbimeve që ofrohen në Berat e shoqëruar me lobimin e fuqishëm nga ana e qarkut Berat.
- ✓ Mungesa e eksperiencës dhe e traditës në Skrapar, vështirëson lidhjen e partneriteteve me organizma të huaja dhe vendase.

### 3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Analiza e nevojave për shërbime sociale e paraqitur tek “Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime Sociale” që i parapriu përgatitjes së Planit Social, mbështet përfundimin se grupet më kritike, të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi janë (shprehur në % kundrejt numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë për shërbime sociale dhe renditur sipas peshës specifike):

1. Fëmijët e familjeve NE (27%)
2. Të tjerë anëtarë të familjeve NE (21%)
3. Të papunë dhe punëkërkues (19%)
4. Individë me AK (të rritur) (15%)
5. Të pastrehë (9%)
6. Të moshuar të vetmuar në nevojë për shërbime (5%)
7. Gra në nevojë për mbrojtje shoqërore (1.4%)
8. Fëmijë me AK (1.4%)
9. Gra të dhunuara (0.08%)

Analiza e thelluar e nevojave për shërbime sociale ndihmoi në identifikimin e prioriteteve që vijnë, të cilat paraqiten të grupuara në tre drejtime themelore:

#### **Drejtimi 1: Kërkesa për shërbime sociale (shërbime që duhet të ofrohen):**

i. Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike”, përkatësisht nëpërmjet *Programit për fuqizimin ekonomik, me prioritet individë të familjeve përfituese të NE si edhe nëpërmjet “Informimi dhe këshillimi”* për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.

ii. Sigurim shërbime sociale për “Fëmijë në familje me NE” nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një qendre komunitare multifunkionale për *fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike, në të cilën të sigurohen edhe shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara.*

iii. Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç me AK” nëpërmjet ngritjes së një qendre ditore që ofron *“Shërbime rehabilituese”* për personat në nevojë për aftësim fizik si edhe ofrim të *“Shërbimeve në familje”* për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të

marrin shërbime ditore komunitare dhe qe e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. Gjithashtu sigurime shërbimet në familje për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

iv. Sigurim shërbim të strehimit social për të pastrehët nëpërmjet programeve përkatëse si 1. Bonusi i qerasë, 2. Banesa sociale me pagesë të reduktuar, dhe 3. Kreditë e buta.

v. Sigurim shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; si edhe Shërbimi i emergjencës 72 orë, për viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.

## **Drejtimi 2: Oferta e shërbimeve ( institucionet dhe kapacitetet)**

i. Fuqizim të kapaciteteve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si edhe të gjithë seksionit të shërbimeve sociale.

ii. Aftësim profesional të ofruesve të shërbimeve sociale.

iii. Krijimi i Fondit Social si instrument i financimit dhe mbështetjes të zhvillimit të shërbimeve sociale.

## **Drejtimi 3: Sigurimi I mundësisë së përdorimit të shërbimeve sociale (bashkëpunimet ndërinstucionale dhe partneritetet)**

i. Fuqizim të kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore

ii. Ndërgjegjësim të komuniteteve të qytetarëve për të drejtat e tyre si edhe mundësitë e realizimit

iii. Ndërgjegjësim të aktorëve dhe operatorëve të biznesit, të shoqërisë civile si edhe të komunitetit ndërkombëtar, për bashkëpunim e partneritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale.

Për rrjedhojë, Plani Social 2020-2022, në kuadrin e qëllimit strategjik të formuluar si instrument për realizimin e misionit dhe të vizionit, do të udhëhiqet nga qëllimet që vijojnë:

### 3.1 Qëllimet

**Qëllimi 1 :** Deri në vitin 2022, të sigurojë funksionimin e programeve të shërbimeve sociale të përshtatshme dhe efektive në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme në përputhje me standartet kombëtare për të gjithë qytetarët në nevojë për shërbime.

**Qëllimi 2:** Deri në vitin 2022, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

**Qëllimi 3 :** Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.

### 3.2 Objektivat, rezultatet e pritshme dhe vlerësimi i tyre

**Qëllimi 1 :** Deri në vitin 2022, të sigurojë funksionimin e programeve të shërbimeve sociale të përshtatshme dhe efektive në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme në përputhje me standartet kombëtare për të gjithë qytetarët në nevojë për shërbime.

**Rezultati Strategjik 1 :** Sistemi i shërbimeve sociale efektive ndërtohet dhe funksionon për të gjithë qytetarët në nevojë, në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

**Treguesit e vlerësimit :** Sipas përcaktimit në Planin e Veprimit

**Vlerat e synuara :**

489 individë në familje me NE dhe 445 Punëkërkues të papunë përfitojnë nëpërmjet “Programit për fuqizimin ekonomik”, si edhe nëpërmjet “Informimi dhe këshillim për punë”.

622 fëmijë në familje me NE dhe 32 fëmijë me AK, përfitojnë shërbime sociale nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një qendre komunitare multifunkionale.

350 individë mbi 18 vjeç me AK, përfitojnë shërbime sociale dhe rehabilitimi nëpërmjet programit të “Shërbimeve në familje” si edhe 118 të moshuar në nevojë për shërbime, nëpërmjet programit të “Shërbimeve në familje”.

210 të pastrehë përfitojnë strehim nëpërmjet programit të strehimit social.

35 gra viktime të dhunës dhe në nevojë për mbrojtje sociale, nëpërmjet programit të Këshillimit, Referimit dhe Shërbimit të Emergjencës, sipas nevojës.

**Vlerat referencë :** Numri i përfituesve të shërbimeve sipas « Analizës së nevojës për shërbime sociale », Qershor 2020.

**Kosto e përgjithshme :** 94,940,000lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit)

**Grupet e interesit të përfshira :** Drejtoria e Ndhmës dhe Përkujdesit Shoqëror, Bashkia Skrapar; Këshilli Bashkiak Skrapar ; Shërbimi Social Shtetëror ; Shërbimi Social Shtetëror, Qarku Berat ; OJF ; UNDP ; Donatorë të tjerë ; Sektori Privat.

**Qëllimi 2:** Deri në vitin 2022, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

**Rezultati Strategjik 2 :** Bashkia Skrapar, në zbatim të kompetencave të saj sipas ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” zbaton politika sociale në përputhje me legjislacionin dhe standartet kombëtare, financiarisht të mbështetura nga Fondi Social dhe Buxheti lokal, të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen, riaftësimin dhe përfshirjen sociale, të individëve në nevojë.

**Treguesit e vlerësimit :** Sipas përcaktimit në Planin e Veprimit

**Vlerat e synuara :**

100% e kapaciteteve administrative të programeve të shërbimeve sociale në bashki, të aftë për të ushtruar kompetencat e tyre, në përputhje me standartet e miratuara.

100% e kapaciteteve të operatorëve publikë dhe jo publikë të shërbimeve sociale, të aftë për të ofruar shërbime cilësore.

100% e nevojës për shërbime, e mbuluar nga Fondi Social.

**Vlerat referencë :** Sipas « Analizës së nevojës për shërbime sociale », Qershor 2020

**Kosto e përgjithshme :** 6,880,000 lekë

**Grupet e interesit të përfshira :** Drejtoria e Ndhmës dhe Përkujdesit Shoqëror, Bashkia Skrapar; Drejtoria e Buxhetit dhe Planifikimit Strategjik, Bashkia Skrapar, Këshilli Bashkiak Skrapar ; Shërbimi Social Shtetëror ; Shërbimi Social Shtetëror, Qarku Berat ; Operatorë të shërbimeve sociale që do të ngrihen në Bashkinë Skrapar, OJF ; UNDP ; Donatorë të tjerë ; Sektori Privat.

**Qëllimi 3 :** Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.

**Rezultati Strategjik 3 :** Qytetarët në nevojë për shërbime sociale, të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre, marrin pjesë në vendimmarrje, duke nxitur miratimin e politikave të qëndrueshme të shërbimeve sociale.

**Treguesit e vlerësimit :** Sipas përcaktimit në Planin e Veprimit

**Vlerat e synuara :**

100% e grupeve në nevojë të qartë dhe të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre si edhe mënyrat e realizimit.

100% e bizneseve private dhe OJF, të gatshëm të investojnë në sigurimin e shërbimeve sociale, pjesëmarrës aktivë në realizimin e politikave të përshtatshme të shërbimeve sociale.

**Vlerat referencë :** Sipas « Analizës së nevojës për shërbime sociale », Qershor 2020.

**Kosto e përgjithshme :** 2,090,000 lekë

Grupet e interesit të përfshira : Drejtoria e Ndhmës dhe Përkujdesit Shoqëror, Drejtoria e Marëdhënieve me publikun, Bashkia Skrapar; OJF ; Donatorë ; Sektori Privat, Media.

**Tabelë përmbledhëse përfundimtare mbi Koston e përgjithshme të Planit Social 2020-2022**

	<b>Gjithsej</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Qëllimi 1</b>	<b>94,940,000</b>	<b>10,860,000</b>	<b>43,490,000</b>	<b>40,590,000</b>
<b>Qëllimi 2</b>	<b>6,880,000</b>	<b>1,840,000</b>	<b>2,520,000</b>	<b>2,520,000</b>
<b>Qëllimi 3</b>	<b>2,090,000</b>	<b>470,000</b>	<b>890,000</b>	<b>730,000</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>103,910,000</b>	<b>13,170,000</b>	<b>46,900,000</b>	<b>43,840,000</b>



#### 4. PLANI I VEPRIMIT

**QËLLIMI 1:** Deri në vitin 2022, të sigurojë funksionimin e programeve të shërbimeve sociale të përshtatshme dhe efektive në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme në përputhje me standartet kombëtare për të gjithë qytetarët në nevojë për shërbime.

**Kosto e përgjithshme e Qëllimit 1: 94,940,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit**

	<b>Gjithsej</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Qëllimi 1</b>	<b>94,940,000</b>	<b>10,860,000</b>	<b>43,490,000</b>	<b>40,590,000</b>
Objektivi 1.1	16,100,000	2,460,000	7,770,000	5,870,000
Objektivi 1.2	33,000,000	1,000,000	16,000,000	16,000,000
Objektivi 1.3	14,000,000	1,000,000	7,000,000	6,000,000
Objektivi 1.4	340,000	100,000	120,000	120,000
Objektivi 1.5	31,500,000	6,300,000	12,600,000	12,600,000

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BAZA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORI MI
<p><b>Objektivi specifik 1.1:</b> Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike”, përkatësisht nëpërmjet <b>Programit për fuqizimin ekonomik</b>, si edhe nëpërmjet “<b>Informimi dhe këshillimi</b>” për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.</p> <p><b>Përfituesit:</b></p> <p><b>489 individë në familje me NE</b>  <b>445 Punëkërkues të papunë</b></p> <p><b>Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.1: Lekë 16,100,000 ( për periudhën 2020-2022)(30 muaj, 2.5 vite)</b></p>							
1.1.1.Krijimi i Agjensisë së Ndërmjetësimit për punë në Bashkinë Skrapar	Bashkia Skrapar	3 mujori Tretë 2020	Numri i përgjithshëm i përfituesve;  Numri I përgjithshëm I përfituesve sipas secilit program;	Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"  Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Skrapar: Të ardhura të vetat, Fondet e Pa-kushtëzuara  Bashkia Skrapar:	Shp.Paga dhe Sigurime (1 person):  Lekë:360,000 viti 1 dhe 720,000/vit për vitin 2 dhe 3, gjithsej 1,800,000 lekë  Shpenzime operacionale: 500,000 /vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa	Muaji 9

			<p>Numri I përfituesve/Nu nrin e synuar</p> <p>Fondi I sipërmarrjes në lekë</p> <p>Fond investimi sipërmarrje I shpenzuar/Përfitues</p> <p>Fondi I formimit profesional në lekë</p> <p>Fond I shpenzuar /për përfitues</p>	<p>Ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”</p> <p>Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 “Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2020</p>	<p>Fondi Social</p> <p>Fondi Zhvillimit Rajonal</p> <p>Agjensia për Nxitjen e SME/ve</p> <p>Fondi Yunus, Shqipëri</p> <p>Donatorë të huaj(UNDP , BE, UNICEF)</p> <p>Burime financimi në përputhje me</p>	<p>250,000 për vitin 1, gjithsej 1,250,000 lekë</p> <p>Shpenzime kapitale: 250,000 lekë për 2.5 vite.</p> <p>Shuma:</p> <p><b>3,300,000 lekë</b> gjithsej, përkatësisht:</p> <p>Viti 1:660,000 lekë</p> <p>Viti 2:1,320,000 lekë</p> <p>Viti 3:1,320,000 lekë</p>	
1.1.2.Krijimi i bazës të të dhënave të informacionit mbi tregun e punës dhe të sipërmarrjeve në territorin e bashkisë Skrapar.	Specialist I Agjensisë dhe Specialist I punësimit	3 mujori Tretë 2020				Pa kosto	Çdo muaj
1.1.3.Organizimi i shërbimit të						Pa kosto	Çdo 3 mujor

ndërmjetësimit për punë					aplikime të hapura		
1.1.4.Organizimi i shërbimit të informimit dhe këshillimit për punë		6 mujori Dytë 2020				Pa kosto	Çdo 3 mujor
1.1.5.Përgatitja e programit për fuqizimin ekonomik të individëve mbi 18 vjeç, përfitues të ndihmës ekonomike	Grup konsulentësh i krijuar nga Bashkia Skrapar  Drejtoria e Ndihmës Ekonomike	6 mujori Parë 2021				3 konsulentë*30 ditë*20,000 lekë/ditë  <b>Lekë 1,800,000</b>	Çdo 3 mujor
1.1.6.Krijimi i fondit të nxitjes së sipërmarrjes dhe vetëpunësimit	Agjensia e Punësimit  Drejtoria e Nidhmës Ekonomike	6 mujori dytë 2021				2% e buxhetit të Bashkisë (të ardhurat e veta)  Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2020 janë parashikuar në PBA: 95,000,000  Fondi nxitjes sipërmarrjes:  <b>1,900,000 lekë</b>	2 herë në vit, çdo 6 muaj

1.1.7. Organizimi i programeve të formimit profesional të individëve mbi 18 vjeç, përfitues të NE	Agjensia e Punësimit  Drejtoria e Ndhmës Ekonomike  Ofrues privatë	6 mujori 1, viti 2021				455përfitues/vit*10,000lekë/përfitues  Gjithsej 925 Individë në nevojë (480 individë NE dhe 445 punëkërkues të papunë), dmth 455 individë në vit do të përfitojnë shërbime  Lekë: 4,550,000/vit  Vetëm viti 2 dhe 3  <b>Gjithsej: 9,100,000 lekë</b>	Çdo muaj
1.1.8. Mbështetja financiare e iniciativave të sipërmarrjes dhe vetëpunësimit	Agjensia e Punësimit  Këshilli Bashkiak	6 mujori 2, viti 2021				4 projekte në vit,  Kosto deri 500,000 lekë  Kosto e përfshirë tek aktiviteti 1.1.6	Çdo 6 muaj
<b>Objektivi specifik 1.2:</b> Sigurim shërbime sociale për “Fëmijë në familje me NE” nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një qendre komunitare multifunkionale për <b>fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike, në të cilën të sigurohen edhe shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara.</b>							

**Përfitues:**

**Fëmijë në familje NE: 622,  
Fëmijë me AK: 32.**

Kapaciteti i qendrës: 50 deri 60 përfitues në ditë, të organizuar në dy turne.

Modeli: Qendra Multifunkionale, Shkozë, Bashkia Tiranë

Shërbimet: Ushqim 1 vakt, edukim, argëtim, këshillim

Shërbim i veçantë: Rehabilitim për fëmijë me aftësi të kufizuara, rreth 12 fëmijë në ditë, në 3 grupe nga 4 fëmijë.

**Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.2: Lekë 33,000,000 ( për periudhën 2020-2022)(pa përfshirë koston e investimit për ndërtimin apo rehabilitimin e qendrës). Qendra do të funksionojë nga viti 2021. Viti 2020, 6 muaji dytë, do të jetë periudhë përgatitore.**

1.2.1. Identifikimi I terrenit apo objektit për ndërtimin apo transformimin në qendër multifunkionale komunitare	Drejtoria e NE dhe NjMF	3 muaji III, 2020	Numri I përfituesve gjithsej  Numri I përfituesve sipas kategorive	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”,  Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”	Bashkia Skrapar: Të ardhura të vetat.  Bashkia Skrapar: Fondet e Pa-kushtëzuara	Pa kosto	Muaji 9
1.2.2. Realizimi i punimeve të infrastrukturës	Bashkia Skrapar	Deri në fund të vitit 2020	Numri I përfituesve në ditë			Kosto variable në varësi të opsioneve.	Çdo muaj
1.2.3. Përzgjedhja e stafit përgjegjës për	Bashkia Skrapar	3 muaji III, 2020		Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994,	Bashkia Skrapar:	Pa kosto	3muaji 3

funkcionimin e qendrës			Numri I fëmijëve me AK të riaftësuar	“Statusi i invalidit ”.	Fondi Social		
1.2.4. Ndërtimi i praktikave të shërbimeve	Grup ekspertësh	3 mujori III, 2020	Kosto për përfitues	Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”	Donatorë të huaj(UNDP , BE, UNICEF)	Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë10,000/ditë	3 mujori 3
			Numri I përfituesve në fakt/plan	Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”	Burime financimi në përputhje me aplikime të hapura	Lekë 500,000	
			Numri I përfituesve/Punonjës	Ligji 22/2018 “Për strehimin social”			
			Niveli I kënaqshmërisë të përfituesve në lidhje me cilësinë e shërbimeve të përfituara.	Ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”			
1.2.5. Hartimi i manualeve të shërbimeve	Grup ekspertësh	3 mujori III, 2020				Kosto e përfshirë tek 2.4.	3mujori 3
1.2.6.Kualifikimi i stafit	Grup ekspertësh I përzgjedhur nga Bashkia/donatori (në rast se	3 mujori IV, 2020				Grup ekspertësh (2) për 10 ditë 2*10 ditë*Lekë25,000 ditë	3 mujori 4

	shërbimi do të ngrihet me mbështetjen e donatorit)					Lekë 500,000	
1.2.7.Mbështetja financiare dhe teknike për funksionimin operacional të qendrës	Këshilli Bashkiak, Bashkia Skrapar	PBA 2020-2022				Kosto operacionale e qendrës: 16 milion lekë në vit, viti 2 dhe 3.  Personel: 10 vetë	Në fund të çdo viti

**Objektivi specifik 1.3:** Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç me AK” nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje” (për persona që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal).

**Përfitues:**

**Individë me AK:**Ndonëse të dhënat dëshmojnë 350 persona gjithsej, vetëm një pjesë e tyre do të kenë nevojë për shërbime në familje, afërsisht kjo llogaritet për rreth 25%, dmth 87 persona

**Të moshuar të vetëm: 118 persona(25% në nevojë për shërbime në familje): 30 persona**

**Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.3: Lekë 14,000,000 ( për periudhën 2020-2022).**



1.3.1. Identifikimi I personave që kanë nevojë për shërbim në familje	Drejtoria e NE dhe Shërbimeve Shoqërore	<b>3mujori III, 2020</b>	Numri I përfituesve gjithsej	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”,	Bashkia Skrapar: Të ardhura të vetat.	Pa kosto	Çdo muaj
1.3.2. Hartimi i praktikave të shërbimit dhe manualeve përkatës	Grup ekspertësh të përzgjedhur nga Bashkia/Donatori	3 mujori IV, 2020	Numri I përfituesve fakt/plan  Numri I përfituesve për 1 punonjës social	Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”  Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.	Bashkia Skrapar: Fondet e Pakushtëzuara  Bashkia Skrapar: Fondi Social  Donatorë të huaj(UNDP , BE, UNICEF)	Grup ekspertësh (2) për 25 ditë  2*25 ditë*Lekë10.000/ditë  Lekë 500,000	Çdo muaj
1.3.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 10 punonjësish socialë të cilët do të ofrojnë me kohë të pjesshme shërbime në familje ( 10 persona, secili përgjegjës për 9 AK dhe 3 Të moshuar, mesatarisht 6 vizita në muaj për një person me AK dhe 12 vizita në muaj për një person të	Bashkia	3 mujori II, 2020	Kosto e shërbimit për një përfitues  Niveli I kënaqshmërisë të përfituesve nga shërbimi	Strategjia e Moshës së Tretë	Burimefinancimi në përputhje	Pa kosto	Muaji 12

moshuar nga 1 punonjës social)					me aplikime të hapura		
1.3.4.Kualifikimi i stafit	Grup ekspertësh të përzgjedhur nga Bashkia/Donatori	3mujori III, 2020				Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë10.000/ditë Lekë 500,000	Muaji 7,8,9
1.3.5.Sigurimi i ambientit të përshtatshëm të punës për ekipin e punonjësve socialë si edhe të paisjeve të nevojshme	Bashkia	6 mujori I, 2021				Shpenzim investimi I njëhershëm: 1,000,000 lekë	Çdo muaj gjatë 6 mujorit 1 të vitit 2021
1.3.6.Sigurimi i mbështetjes financiare për funksionimin e shërbimit	Këshilli Bashkiak	PBA 2020-2022				10 persona*12 muaj*50,000 lekë/muaj=6,000,000 në vit	Në fund të çdo viti
<p><b>Objektivi specifik 1.4:</b> Sigurim shërbime sociale për “Gra në nevojë dhe të përjashtuara” nëpërmjet ofrimit të “Shërbimit të emergjencës 72 orë” për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, si dhe nëpërmjet ofrimit të “Shërbimit të strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje”</p> <p><b>Përfitues:</b> <b>35 Gra në nevojë për shërbime përfshi dhe viktimat e dhunës në familje</b></p>							

**Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.4: Lekë 340,000 ( për periudhën 2020-2022).**

1.4.1. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e lidhura me menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë dhe dhunës në familje	Njësia menaxhimit rasteve dhe referimit	<b>3 mujori 3 viti 2020</b>	Numri i përfituesve/numri kërkuesve  Niveli i kënaqshmërisë	Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”  Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”	Bashkia Skrapar: Të ardhura të vetat.  Bashkia Skrapar: Fondet e Pa-kushtëzuara	Pa kosto	Muaji 12 viti 2020
1.4.2. Kualifikimi i stafit	ShSSH	<b>3 mujori 4 viti 2020</b>	% e reduktimit të dhunës me bazë gjinore  % e rasteve të referuara	Ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.	Bashkia Skrapar: Fondi Social  Donatorë të huaj (UNDP, UN-WOMEN, UNICEF)	Pa kosto  Komponent I aktivitetit të drejtorisë shërbimeve sociale	Muaji 12 viti 2020
1.4.3. Ngritja e strukturës dhe operacionalizimi i shërbimit online dhe telefoni (kosto operacionale)			% e rasteve të zgjidhura		Bashkia Skrapar: Fondi Social  Donatorë të huaj (UNDP, UN-WOMEN, UNICEF)  Burime financimi në	1 punonjës nga strukturat ekzistuese.  Kosto operacionale:10,000 lekë në muaj  Viti 2 dhe 3: 240,000 lekë	Çdo muaj

					përputhje me aplikime të hapura	Kosto investimi: hapja e shërbimit online, programi dhe mirëmbajtja e faqes: 100,000 lekë (viti 1)  Gjithsej:340,000 lekë	
--	--	--	--	--	---------------------------------	---	--

**Objektiv specifik 1.5. Ofrimi i programit të Strehimit Social nëpërmjet bonusit të qerasë dhe kredive të buta, në varësi nga burimet e Bashkisë**

**Përfitues: 210 të pastrehë përfitojnë strehim nëpërmjet programeve përkatëse të strehimit social.**

**Kosto e Objektivit 1.5: Kosto operacionale e programit është e përfshirë tek aktivitetet e qëllimit 2 dhe 3 sepse programi menaxhohet nga Njësia Përkatëse e Bashkisë. Kosto e shërbimit përfshin përfitimin e çdo familje(5,000 lekë në muaj x 210 familje), gjithsej 6,300,000 viti 1 dhe 12,600,000 në vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa 31,500,000 lekë për të gjithë periudhën 2.5 vite, 2020-2022.**

**QËLLIMI 2:** Deri në vitin 2022, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

**Kosto e përgjithshme e Qëllimit 2 : 6,880,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit**

	Gjithsej	2020	2021	2022
<b>Qëllimi 2</b>	<b>6,880,000</b>	<b>1,840,000</b>	<b>2,520,000</b>	<b>2,520,000</b>
Objektivi 2.1	5,400,000	1,080,000	2,160,000	2,160,000
Objektivi 2.2	900,000	180,000	360,000	360,000
Objektivi 2.3	580,000	580,000	0	0

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FI-NANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<b>Objektivi specifik 2.1:</b> Fuqizim të kapaciteteve të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si edhe të gjithë seksionit të shërbimeve sociale							
<b>Përfitues:</b>							
20 punonjës të shërbimeve sociale ( Punonjës të administratës ekzistuese, shtesat e reja si edhe të shërbimeve që do të ndërtohen)							
Kosto totale: 5,400,000 lekë (2.5 vite)							

<p><b>Aktiviteti 2.1.1.</b> Rritje e numrit të punonjësve socialë me tre punonjës.</p>	<p>Bashkia, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Financës  Këshilli Bashkiak</p>	<p>3mujori 3,  Viti 2020</p>	<p>Numri I punonjësve gjithsej  Shkalla e përputhjes të numrit në raportin me standartet  Kosto për një punonjës</p>	<p>Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e</p>	<p>Bashkia, të ardhurat e veta</p>	<p>1,800,000 në vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa 900,000 për vitin 1.  3 punonjës, Paga bruto 50,000 /muaj.  Gjithsej: 4,500,000 lekë</p>	<p>Çdo muaj</p>
--	--	--------------------------------------	--	--	------------------------------------	--	-----------------

<p><b>Aktiviteti 2.1.2</b> Organizim kurs formimi dhe riformimi profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale.(kurs 3 ditor, çdo 6 muaj)</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore</p> <p>Bashkia Skrapar</p> <p>Shërbimi Social Shtetëror</p>	<p>Çdo 6 muaj</p>	<p>Numri I personave të trainuar</p> <p>Shkalla e përfitimit të njohurive mbi praktikat më të mira.</p> <p>Shkalla e zbatimit të praktikave më të mira</p>	<p>fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".</p> <p>VKM Nr.334, datë 17.2.2011, "Për Mekanizmin e Bashkëndimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"</p>	<p>Bashkia, Transfertat e pakushtëzuara ,</p> <p>Shërbimi Social Shtetëror</p> <p>ASPA</p> <p>Donatorë</p>	<p>5 kurse për 2.5 vite</p> <p>4 lektorë në secilin kurs</p> <p>20 pjesëmarrës</p> <p>Kosto 1 kurs:180,000 lekë</p> <p>360,000 lekë/vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa 180,000 lekë për vitin 1.</p>	<p>Vlerësim pas çdo trainimi.</p> <p>Vlerësim nëpërmjet pyetsorit individual të plotësuar nga pjesëmarrësit.</p>
---	---	-------------------	--	---	--	---	--

**Objektiv specifik 2.2:** Aftësim profesional të ofruesve të shërbimeve sociale.

Përfitues: Ofruesit e shërbimeve sociale të institucioneve publike ose jo publike

Kosto e përgjithshme: 900,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

<p><b>Aktiviteti 2.2.1</b> Ndërtimi I bazës të të dhënave të operatorëve të shërbimeve sociale, publikë dhe jo publikë.</p>	<p>3 mujori 1, 2021</p>	<p>Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale</p>	<p>Numri I personave të trainuar</p> <p>Shkalla e përfitimit të njohurive mbi praktikat më të mira.</p>	<p>Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë</p> <p>VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".</p>	<p>Bashkia, të ardhurat e veta dhe fondet e pakushtëzuara</p>	<p>Pa kosto</p>	<p>Çdo muaj</p>
<p><b>Aktiviteti 2.2.2</b> Formim profesional cilësor dhe I vazhdueshëm për ofruesit e shërbimeve sociale</p>	<p>Çdo 6 muaj</p>	<p>Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale</p>	<p>Shkalla e zbatimit të praktikave më të mira.</p> <p>Niveli I kënaqshmërisë të përfituesve</p>	<p>Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë</p> <p>VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".</p>	<p>Bashkia, të ardhurat e veta, Shërbimi Social Shtetëror ASPA Donatorë</p>	<p>5 kurse për 2.5 vjet 4 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë 360,000 lekë/vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa 180,000 lekë për vitin 1</p>	<p>Vlerësim pas çdo trainimi. Vlerësim nëpërmjet pyetsorit individual të plotësuar nga pjesëmarrësit.</p>
<p><b>Objektiv specifik 2.3.</b> Krijimi i Fondit Social si instrument i financimit dhe mbështetjes të zhvillimit të shërbimeve sociale.</p> <p>Kosto e përgjithshme: Lekë 580,000, por nuk është përfshirë Buxheti Social në lekë</p>							



<p><b>Aktiviteti 2.3.1.</b> Vlerësimi I mundësive për krijimin e fondit social nga pikëpamja financiare dhe buxhetore</p>	<p>3 majori 3, 2020</p>	<p>Drejtoria e Buxhetit  Grup ekspertësh</p>	<p>Fondi social në % të Buxhetit total të bashkisë  Fondi Social për vitit 2020, 2021, 2022</p>	<p>VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.  Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave</p>	<p>Bashkia, të ardhurat e veta  Donatorë</p>	<p>2 ekspertë, 10 ditë, 25,000 lekë /ditë  Lekë 500,000</p>	
<p><b>Aktiviteti 2.3.2</b> Ndërgjegjësimi I qeverisjes vendore dhe këshillit bashkiak mbi nevojën e krijimit të fondit social nëpërmjet organizimit të 2 tavolinave të diskutimit</p>	<p>3 majori 4, 2020</p>	<p>Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale</p>	<p>Ritmet vjetore të rritjes të fondit social</p>	<p>“Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.  VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.</p>	<p>Donatorë</p>	<p>30 pjesëmarrës,  ½ ditë  Lekë 80,000</p>	
<p><b>Aktiviteti 2.3.3</b> Krijimi i fondit social dhe përfshirja në PBA</p>	<p>3 majori 3, 2020</p>	<p>Këshilli Bashkisë Skrapar</p>			<p>Bashkia, të ardhurat e veta</p>	<p>Sipas përcaktimit në VKM</p>	

--	--	--	--	--	--	--	--

**Qëllimi 3 :** Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.

**Kosto e përgjithshme e Qëllimit 3 : 2,090,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit**

	<b>Gjithsej</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Qëllimi 3</b>	<b>2,090,000</b>	<b>470,000</b>	<b>890,000</b>	<b>730,000</b>
Objektivi 3.1	1,060,000	260,000	440,000	360,000
Objektivi 3.2	870,000	210,000	370,000	290,000
Objektivi 3.3	160,000	0	80,000	80,000

<b>AKTIVITETET</b>	<b>AKTORËT PËRGJEGJËS</b>	<b>AFATI</b>	<b>TREGUESIT</b>	<b>BAZA LIGJORE</b>	<b>BURIMI I FINANCIMIT</b>	<b>KOSTO</b>	<b>MONI-TORIMI</b>
--------------------	---------------------------	--------------	------------------	---------------------	----------------------------	--------------	--------------------

**Objektivi specifik 3.1:** Fuqizim të kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore në drejtim të rritjes së mundësive për ofrim të shërbimeve të qëndrueshme.

Përfitues: 20 punonjës të Bashkisë ( Seksioni Ndhimës dhe Përkujdesit Shoqëror, Drejtoria/Seksioni i marëdhënieve me publikun)

Kosto e objektivit specifik 3.1: 1,060,000 lekë

<p>Aktiviteti 3.1.1. Organizim tryezë diskutimi ( dy tryeza)me donatorë me qëllim rritjen e bashkëpunimit</p>	<p>3 mujori 4, 2020  3 mujori 2, 2021</p>	<p>Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale</p>	<p>Numri I projekteve të aplikuara  Numri I projekteve të fituara  Raporti I projekteve të fituara në krahasim me projektet e aplikuara  Buxheti total I projekteve të fituara</p>	<p>Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e</p>	<p>Bashkia, të ardhurat e veta,</p>	<p>30 pjesëmarrës ,  ½ ditë  Lekë  80,000/1 tryezë  160,000 lekë/2 tryeza</p>	<p>Çdo 6 muaj gjatë vitit të pare të zbatimit të planit.</p>
<p>Aktiviteti 3.1.2. Program trainimi “Rritja e fondeve nëpërmjet hartimit dhe menaxhimit të projekteve”</p>	<p>Çdo 6 muaj</p>	<p>Drejtoria e ndihmës dhe</p>	<p>Buxheti total I projekteve të</p>		<p>Bashkia, të ardhurat e veta,</p>	<p>5 kurse për 2.5 vite</p>	<p>Vlerësim pas çdo trainimi.  Vlerësim nëpërmjet</p>

		Shërbime ve Sociale	fituara në krahasim me Buxhetin e Bashkisë (në%)	nevojshme për mbrojtjen e fëmijës". VKM Nr.334, datë 17.2.2011, “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij”	Shërbimi Social Shtetëror ASPA Donatorë	4 lektorë në sccilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë 360,000 lekë/vit për vitin 2 dhe 3, ndërsa 180,000 për vitin 1.	pyetsorit individual të plotësuar nga pjesëmarrësit .
--	--	---------------------	--	---	---	---	---

**Objektivi specifik 3.2:** Ndërgjegjësim të komuniteteve të qytetarëve për të drejtat e tyre si edhe mundësitë e realizimit

Përfitues: Komunitetet e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale

Kosto e përgjithshme e objektivit 3.2: 870,000 lekë

Aktiviteti 3.2.1 Organizim programe televizive në TV lokal mbi të drejtat sociale.	Çdo 3 mujor, Viti 2021	Drejtoria për Marëdhëniet me Publikun	Numri I fushatave të informimit të organizuara	Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”		Pa kosto	Në fund të çdo 3 mujori.
---	---------------------------	---------------------------------------	--	---	--	----------	--------------------------

			Numri I pjesëmarrësve	Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”			
Aktiviteti 3.2.2 Informim I publikut nëpërmjet faqes web të Bashkisë	3 mujori 3, Viti 2020 Mirëmbajtje vazhdimisht	Drejtoria për Marëdhëniet me Publikun	Numri I grupeve të targetuara dhe të përfshira. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit çdo vit.	Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”  Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”,  Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”		Pa kosto	Në fund të 3mujorit 3/të
Aktiviteti 3.2.3 Prodhim dhe shpërndarje të broshurave informative	3 mujori 4, viti 2020	Drejtoria për Marëdhëniet me Publikun		Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.  Ligji 22/2018 “Për strehimin social”  Ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”	Bashkia, të ardhurat e veta,	Lekë 50,000/vit  Gjithsej 150,000 lekë	3 mujori 1, viti 2021
Aktiviteti 3.2.4 Organizim tryeza diskutimi me grupet qytetare mbi bazë komuniteti, në secilën njësi administrative, 9 njësi.	3 mujori 1,2,3,4 Viti 2021 3 mujori 1, viti 2022	Drejtoria për Marëdhëniet me Publikun			Bashkia, të ardhurat e veta,	30 pjesëmarrës , ½ ditë  Lekë 80,000/1 tryezë  Lekë 720,000	Çdo 3 mujor dhe në fund të vitit 2021 dhe 2022.

						(9 tryeza)	
<p><b>Objektivi specifik 3.3:</b> Ndërgjegjësim të aktorëve dhe operatorëve të biznesit, të shoqërisë civile si edhe të komunitetit ndërkombëtar, për bashkëpunim e partneritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale.</p> <p>Përfitues: Të gjithë aktorët e biznesit privat dhe shoqërisë civile</p> <p>Kosto e përgjithshme e objektivit specifik 3.3.: 160,000 lekë</p>							
Aktiviteti 3.3.1.  Ndërtimi i bazës së të dhënave për të gjithë operatorët e biznesit privat në territorin e bashkisë, në qarkun e Beratit si edhe OJF në Bashki dhe në qark.	3 majori 2, 2020	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	Numri I tryezave të realizuara/planifikuar  Numri I pjesëmarrësve dhe sipas kategorisë së pjesëmarrësve	Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"  Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"		Pa kosto	3 majori 1, 2021  3 majori 1, 2022
Aktiviteti 3.3.2. Organizim tryezë diskutimi ( dy tryeza) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile dhe sektorit privat	3 majori 1, viti 2021  3 majori 2, Viti 2022	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit  Rritja e shkallës së përfaqësimit të interesave të	Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"	Bashkia, të ardhurat e veta,	Lekë 80,000/1 tryezë	3 majori 2, 2021  3 majori 3, 2022

			komuniteteve në nevojë.			Lekë 160,000(2 tryeza)	
--	--	--	----------------------------	--	--	------------------------------	--

## **5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

Monitorimi i planit të veprimit do të drejtohet nga grupi tematik për shërbimet sociale, pjesë e përgatitjes së strategjisë dhe planit të veprimit, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Treguesit e përcaktuar për monitorimin dhe vlerësimin e Planit të Veprimit do të shërbejnë për realizimin e monitorimit, sipas periudhave të përcaktuara në Plan. Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik dhe analizimin e progresit dhe problemeve në secilën prej politikave prioritare. Raporti I standartizuar do të përmbajë fakte dhe të dhëna të standartizuara, bazuar në kornizën e indikatorëve të parashikuar nga ky plan lokal.

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore kombëtare përgjegjëse për mbrojtjen sociale (përfshi Shërbimi Social Shtetëror), përfaqësues nga qarqet akademike dhe qendrat universitare, shoqëria civile, (përfaqësues të shoqatave të formuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave të grupeve të përjashtuara) etj,

Draftet e raporteve vjetore të monitorimit do të përgatiten në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe do të miratohen nga Këshilli Bashkiak.

Në mbështetje të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit, lidhur me treguesit e ndikimit do të jenë edhe të dhënat administrative të siguruar nga studime lokale mbi përjashtimin social dhe përfshirjen sociale.



## REFERENCAT

### Ligje

1. Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"
3. Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
4. Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit",
5. Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"
6. Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ".
7. Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
8. Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit"
9. Ligji 22/2018 "Për strehimin social"
10. Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

### Strategji Kombëtare

1. Vendim nr. 1071, datë 23.12.2015, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2015-2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"
2. Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020.
3. Vendim nr.87, datë 3.6.2016 "Për miratimin e dokumentit politik të përfshirjes sociale 2016-2020".

### VKM në zbatim të ligjit

1. VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".
2. Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".
3. VKM Nr.334, datë 17.2.2011, "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"
4. VKM Nr.233, datë 10. 4.1998 "Për zbatimin e Ligjit "Për statusin e jetimit"

5. VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
6. VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.
7. Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

#### **Urdhëra/Udhëzime Ministri**

1. Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 “Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2020.

## SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Analiza e individëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror mundësoi identifikimin e 2,301 individëve që aktualisht kanë nevojë për të paktën një nga tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Tabela 4: Individë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror për çdo njësi administrative**

TË DHËNA DEMOGRAFIKE	KATEGORITË	Bogovë	Çepan	Çorovodë	Gjerbës	Leshnje	Potom	Qëndër	Vëndreshë	Zhepë	Gjithësej
		Numër banorë INSTAT	1098	740	4051	813	496	897	2545	984	779
	Numër banorë ZGjC	1693	913	5666	1210	735	1055	3834	1098	788	16992
	Numër familje INSTAT	366	279	1506	286	172	317	857	394	266	4443
	Numër familje ZGjC	564	344	2106	426	255	373	1291	440	269	6068
	Fëmijë 0-15 vjeç INSTAT	223	165	566	184	117	136	504	257	42	2194
	Fëmijë 0-18 vjeç ZGjC	392	317	794	362	181	226	724	318	55	3369
	Grupmosha 16-64 vjeç INSTAT	1247	623	4219	869	518	782	2737	685	606	12.286
	Grupmosha 19-64 vjeç ZGjC	1078	471	3991	691	454	692	2517	624	593	11.111
	Grupmosha mbi 65 vjeç ZGjC	223	125	881	157	100	137	593	156	140	2512
INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME	Individë mbi 18 vjeç në familje me N.E	32	26	34	50	39	77	119	50	62	489
	Të papunë	39	6	318	5	2	15	60	0	0	445
	Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç	25	25	116	27	21	20	72	25	19	350
	Fëmijë në nevojë për mbrojtje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Fëmijë në familje me ndihmë ekonomike	46	33	57	63	49	90	143	53	88	622
	Fëmijë me aftësi të kufizuara	2	1	9	5	1	2	8	4	0	32
	Viktima të dhunës në familje	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
	Të moshuar në nevojë për shërbime	7	5	30	10	3	15	35	6	7	118

	Gra në nevojë për shërbime	2	1	14	3	0	3	6	2	2	33
	Të pastrehë	3	1	178	5	3	5	8	5	2	210
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>156</b>	<b>99</b>	<b>757</b>	<b>168</b>	<b>118</b>	<b>227</b>	<b>451</b>	<b>145</b>	<b>180</b>	<b>2301</b>
	<b>Në përqindje sipas popullsisë/ZGjC</b>	<b>9%</b>	<b>11%</b>	<b>13%</b>	<b>14%</b>	<b>16%</b>	<b>21%</b>	<b>12%</b>	<b>13%</b>	<b>23%</b>	<b>13.5%</b>

## SHTOJCA 2. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shërbimet e kujdesit shoqëror janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror<sup>13</sup>.

Shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror është rregulluar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Në përputhje me këtë VKM shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në tre grupe:

- a) **Shërbime parashoqërore:** informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *on-line*;
- b) **Shërbime në komunitet:** shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.
- c) **Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.**

### Shporta e shërbimeve përbëhet nga:

**1. Informimi dhe këshillimi** janë shërbime që synojnë përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.

**2. Ndërhyrja e hershme,** është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.

**3. Shërbimet në familje** janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

---

<sup>13</sup> Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Neni 3

**4. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror** siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

**5. Shërbimi multifunksional** përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh multidisiplinare të specializuara dhe u ofrohet të gjitha kategorive në nevojë.

**6. Qendrat ditore** ofrojnë shërbim gjysmëditor ose të plotë ditor, të cilat mund të përdoren një ose disa ditë në javë dhe sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve: (i) **fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike**; (ii) **personat me aftësi të kufizuara**; (iii) të moshuarit;

**7. Shërbimi i emergjencës 72 orë** u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky shërbim ngrihet për: i. Viktima të dhunës në familje dhe fëmijët; ii. Fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara; iii. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.

**8. Shërbimi për të pastrehët** ofrohet për individë mbi 18 vjeç që nuk kanë strehë banimi dhe janë në vështirësi ekonomike.

**9. Shërbimi i strehimit të mbrojtur** u ofrohet viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë. Ai organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.

**10. Shërbime në qendrat e zhvillimit**, që sigurojnë përmirësimin e statusit dhe të cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.

**11. Strehimi afatgjatë**, i cili i sigurohet individit që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore. Ky shërbim u ofrohet: i. **Personave me aftësi të kufizuara**; ii. **Të moshuarve dhe të sëmurëve rëndë**, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare.

**12. Shërbimi në strehëza**, që u siguron përfituesve shërbim strehimit, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim rezidencial ofrohet në mënyrë të përkohshme (i) **për fëmijën** që gjendet i pambikëqyrrur nga prindërit, në rrezik apo në situatë e rruge; (ii) për fëmijën në nevojë të mbrojtjes së veçantë; (iii) **për të rriturin ose të moshuarin** që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të

kujdeset për veten; (iv) **për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç**; (v) për fëmijën dhe të rriturin, **viktimë të dhunës në familje, të abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit** ose në rrezik të mundshëm për jetën; (vi) për fëmijën dhe të rriturin **në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social**; (vii) për fëmijën në konflikt me ligjin.

**13. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese** që ofrohen në territorin e bashkisë ose në territorin e rajonit për fëmijë: me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik.

**14. Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual** që ofrohet për viktimën e abuzimit seksual.

**15. Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje**, që ofrojnë shërbim në mënyrë të përkohshme, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat e dhunës në familje që kanë marrë urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

**16. Qendrën për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit**, që ofron shërbim në mënyrë të përkohshme.

**17. Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar**, që ofrohet si shërbim ditor dhe përfshin shërbime rehabilituese sipas nevojave të identifikuara nga njësitet e specializuara mjekësore dhe nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

**18. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line** është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara.